

# CITY OF GJILAN COMMUNITY PROFILE

2014

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - Gjilan  
Fadil OSMANI, Zyrtar për Promovimin e Investimeve  
mob: +377 45 218 100  
E-mail: fadilosmani02@yahoo.com

## PROFILI I KOMUNITETIT - COMMUNITY PROFILE

### Karakteristikat e komunitetit

- Lokacioni

Komuna e Gjilanit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoraves, me një sipërfaqe prej 515 km<sup>2</sup>, deri në vitin 2010 kur me procesin e decentralizimit i merren 123 km<sup>2</sup>, Komuna e Gjilanit tani ka 392 km<sup>2</sup>. Pozita e mirë gjeografike që ka, i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit.




Foto 1. Harta Kosova dhe Regioni i Gjilanit

Komuna e Gjilanit kufizohet : në juglindje me Preshevën (33km) dhe Kumanovën (malet e Karadakut), në lindje me Bujanovcin (40.5km), në verilindje Kamenicën (29km), në jug ka Vitinë (20km), në perëndim Lipjanin dhe Prishtinën (47km) në verilindje me Novobërdën,(19.5km)

Në komunën tonë 49 lokalitete janë të banuara vetëm me Shqiptarë, 5 fshatra të komunës janë të përziera Shqiptarë - Serbë, 1 Shqiptarë - Turq dhe rreth 9 lokalitete janë të banuara me Serbë, popullsia e llogaritur përafërsisht është 145.804 banor, ku jetojnë këto komunitete: Shqiptarë, Serbë, Turq, Romë dhe të tjerë.


Karakteristikat e terrenit : Vetë qyteti shtrihet në një fushëgropë të gjërë. Ndërkaq territori i komunës ka parakushte të mira për bujqësi dhe njihet si komunë agro-industriale. Kategorizimi i tokave në bazë të përbërjes gjeologjike, mund të bëhet vetëm pas një hulumtimi të thellë pedologjik, por ajo që tash dihet është se në Komunën e Gjilanit dominojnë tokat e kuqe argillore të cilat shtrihen rrëzë maleve, tokat aluviale që shtrihen në të dy anët e lumit Morava dhe lumenjëve të tjerë më të vegjël, si dhe tipi i tokave smonicë që kryesisht shtrihen në pjesën qëndrore të komunës. Në juglindje ka malet e Karadakut si dhe një pjesë të Rrafshit të Kosovës – fushë pjellore.

○ Përshkrimi themelor

*Regioni i Gjilanit përfshin komunat :*

- **Dardanën (Kamenicën) (29km)** : është komuna më lindore e Kosovës, që kufizohet me kufirin e Serbisë, Prishtinën, Artanën dhe Gjilanin. Afro 58,500 banorë jetojnë në 74 fshatra, në bazë të regjistrimit të vitit 1991, aktualisht popullata përbëhet nga afro 79 për qind shqiptarë, 21 për qind serbë, përfshirë në këtë shifër edhe një përqindje të vogël të romëve sipërfaqja 523 km<sup>2</sup>.
- **Novobërdën (19.5km)** : karakterizohet për dy gjëra : është komuna më e vogël në Kosovë me vetëm 90km<sup>2</sup> me përafërsisht 4.500 banorë dhe ka një baraspeshë të mirë demografike me 50 % shqipëtar dhe 50 % serbë .
- **Vitinë (20km)** : Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, kufizohet me tri komuna të tjera (Gjilanin, Ferizajn dhe Kaçanikun) dhe me Republikën e Maqedonisë. Numri i përgjithshëm i popullsisë: 68,633, Dendësia e popullsisë: 231 banorë për një km<sup>2</sup>, 70% e popullsisë është ndërmjet moshës 18 dhe 35 vjeçare .
- **Ferizajn (32km)** : Komuna e Ferizajt ka 720 km katrorë, ka gjithsejt 44 fshatra , në të cilat jetojnë gjysma e popullatës së kësaj komune . Komuna e Ferizajt ka afro 145.000 banorë , prej tyre gjysma jetojnë në qytet dhe gjysma në fshatra . Nga komunitetet tjera jetojnë rreth 3700 banorë , kryesisht Ashkalinjë,Romë,Goranë,Musliman,Serbë .
- **Kaçaniku** : shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, me një pozitë të volitshme gjeografike. Karakteristikat kryesore të komunës janë: Një sipërfaqe prej 306 km<sup>2</sup>, Terren malor me gryka të mprehëta; kryesisht të pyllëzuara (60%), Komuna e Kaçanikut ka një popullatë të vlerësuar prej 50,000 banorësh.
- **Shterpca** : ka një pozitë të volitshme gjeografike. Karakteristikat kryesore të komunës janë: Një sipërfaqe prej 247 km<sup>2</sup>, ka një popullatë të vlerësuar prej 13,633 banorësh, dendësia 55 banorë në /km<sup>2</sup> .

○ Harta rajonale



*Foto 2 : Harta rajonale para dhe pas procesit te decentralizimit*

- Popullata

- E tashme<sup>1</sup>

Komuna e Gjilanit në bazë të regjistrimit të fundit të bërë nga Enti Statistikor i Kosovës ka këtë strukturë të popullësisë

| Banesat | Ekonomit familjare | Gjithësejt | Meshkuj | Femra |
|---------|--------------------|------------|---------|-------|
| 23186   | 17048              | 90015      | 45323   | 44692 |

\*Sipas regjistrimit të fundit, prill 2011, komuna e Gjilanit ka 90.015 banorë, pa qytetarët në botën e jashtme.

- E kaluar

Popullësia e Gjilanit, përherë ka qenë e përzier, me dominimin e shqiptarëve, si gjatë sundimit turk, ashtu edhe atij serbo-jugosllav. Sipas publikimit të Entit të Statistikave të Kosovës, dhjetor 2002, numri i përgjithshëm i banorëve ishte 133.724 (68.814 meshkuj dhe 64.910 femra), prej tyre 116.246 janë shqiptarë ndërsa 17.478 nga komunitetet tjera. Në zonën urbane jetojnë 79.898 banorë, ndërsa pjesa tjetër në viset rurale.

Numri bruto i popullatës sipas vlerësimeve në komunën e Gjilanit

| Vitet              | 1981   | 1991    |
|--------------------|--------|---------|
| Meshkuj            | 43 294 | 53 360  |
| Femra              | 40 791 | 50 315  |
| Gjithësejt (Bruto) | 84 085 | 103 675 |
| Gjithësejt (Neto)  | 35 229 | 51 912  |

Struktura nationale e popullsisë së komunës së Gjilanit vlerësohet të jetë kështu: 116 246 Shqiptarë (86.9 %), 12 500 Serbë (9.4 %), 133 Malazias (0.1 %), 936 Turq (0.7%), 267 Boshnjakë (0.2 %), 3 610 Romë (2.7 %) dhe 32 të Tjerë. Vlerësohet se në vitin 2002, numri i banorëve në 1 km<sup>2</sup> ka qenë 254, ose një rritje prej 55.83% në krahasim me vitin 1981, kur numri i banorëve në 1 km<sup>2</sup> ishte 163. Norma vjetore neto e rritjes së popullatës është vlerësuar të jetë rreth 2.3%.

- Përshkrim i shkurtër i komunës

Gjilani është qendër e mirëfilltë e regionit të Anamoravës, e cila bashkë me komunat pranë saj, Vitinë, Kllokotin, Parteshin, Novo Brdën, Kamenicën e Ranillugun, por edhe me Preshevën dhe Bujanocin, përbejnë një komunitet prej rrëth gjysmë milioni banorësh.

Gjilani është qendër kulturore, ekonomike dhe arsimore e këtij regjioni dhe natyrshëm ai edhe po e luan këtë rol, sidomos me hapjen dhe modernizimin e arterieve komunikuese ndërkufitare me Serbinë dhe Maqedoninë, por edhe me përcaktimin e saktë të komunës dhe qeverisë që në Gjilan të themelohet njëri nga Universitetet Publike të Kosovës, i cili duhet të fillojë me punë qysh në tetor të vitit 2011.

Për këto vite pas luftës Komuna po bën përpjekje maksimale që ta zhvillojë infrastrukturën dhe bazën ekonomike të saj, sepse ende numri i atyre që kërkojnë punë në komunë, është tejet i madh.

Gjilani daton nga viti 1772 dhe është themeluar nga familja e Gjinajve, e cila që nga viti 1737 ka sunduar një pjesë të Kosovës. Sulltani ka njojur pushtetin e kësaj familje.

Gjinajt erdhën në Gjilan nga qyteti mesjetar i Artanës (Novobërdë). Si themelues njihet Bahti Beg Gjinolli. Qyteti shtrihet në një fushëgropë të gjerë, ka kushte të mira për bujqësi dhe njihet si qytet agro-industrial.

Nga 15 shkurti 2003, Gjilani është seli e zyrës së Agjensionit për Demokraci Lokale të Këshillit të Evropës. Është binjakëzuar ose ka nënshkruar partneritet me komunat: komunën e Kukësit (Shqipëri), Iperit (Belgikë), Luterbahut (Francë) Yildirim (Turqi), Kumanovën (Maqedoni), po ashtu Gjilani eshte edhe antare e Asociacioni i Komunave Turke në Botë (TDBB), shiko : [www.tdbb.org.tr](http://www.tdbb.org.tr)

---

<sup>1</sup> [www.esk.rks-gov.net](http://www.esk.rks-gov.net)

Janë shënuar përparime të dukshme në ndërtimin e rrjetit të rrugëve, si në zonën urbane, ashtu edhe nëpër fshatra. Janë ndërtuar dhjetëra kilometra ujësjellës e kanalizime në tërë hapësirën e komunës si dhe është punuar shpejt dhe mirë në zgjerimin e hapësirës shkollore dhe pajisjen e shkollave me inventar të ri.

Është punuar mirë në ndërtimin e zonave të gjelbra, parkingjeve e trotuareve dhe në mirëmbajtjen e pastrimin e ambientit, kudo në komunë.

Ambicet e tonë janë që të ndërtojmë parakushte të mira për ardhje të investimeve në komunën e Gjilanit dhe për zhvillim sa më të shpejtë ekonomik të saj. Bashkë me Institucionet Nderkombetare po punojmë në hartimin e strategjisë zhvillimore të rajonit të lindjes, ku përfshihet edhe komuna jonë, ndërtimi i një zone ekonomike me infrastrukturë moderne dhe me shërbime të mira dhe të lira publike, është njëri nga hapat e parë që do të bëjmë, tani u kemi hapur derën dhe po punojmë shumë në inkurajimin e investimeve nga brenda dhe jashtë, ne e shohim zhvillimin ekonomik në agrikulturë, në pylltari, në përpunim të lehtë industrial, në ndërtim, në shërbime transporti dhe shërbime tjera ndërkufitarë e ndërshtetërore si dhe në aplikimin e dijes për të gjitha këto lëmi.

### **Transportimi (gjithmonë përfshini distancën dhe kohën e udhëtimit nga komuna)**

- Magjistralet
  - Rrugët kryesore të transportit dhe mundësia e qasjes nëpër tregje

Pozita gjeografike i mundëson lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, duke qenë edhe një qendër e rëndësishme në trekëndshin Gjilan-Preshevë-Kumanovë.

- Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Serbisë bëhet përmesë :

- Rrugës magjistrale Gjilan – Bujanovc - Vranjë nëpër grykën e Konqulit, përmesë kësaj rruge Kosova del më lehtë boshtin meridinal ballkanik nëpër luginën e Moravës ku pastj lidhet me autostraden Beograd – Shkup
- Lidhja tjeterë e komunës së Sonë me Serbinë bëhet përmesë rrugës regionale Gjilan- Pasjan – Muçibab – Preshevë dhe del në magjistralen Preshevë – Shkup .

- Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Maqedonisë tentohet te bëhet përmesë :

- Lidhja tjeterë e komunës së Sonë me Maqedonin ( Kumanoven ) tentohet të bëhet bëhet përmesë rrugës regionale Gjilan- Zhegër – Stanqiq – Kumanovë dhe del në magjistralen Beograd – Athinë gjegjësistë prek koridorin 8 dhe 10

Rruget magjistrale te rendesis se veqant ne qarkullimin e lire te mallrave dhe njerzve qe lidhin Komunen e Gjilanit me qendrat tjera dhe shtet tjera e ato jane :

| Nr. | Emërtimi i rrugëve   | Gjatësia |
|-----|--|----------|
| 01  | Rruga Gjilan – Muqyybabë – Preshevë (Serbi) dalja ne korridorin 10   | 33 km    |
| 02  | Rruga Gjilan - Kamenicë – Bujanovcin (Serbi) dalja ne korridorin 10  | 40.5 km  |
| 03  | Gjilan- Zhegër – Stanqiq – Kumanovë (Maqedoni) dalja ne korridorin 8 | 35 km    |
| 04  | Rruga Gjilan – Partesh – Viti - Ferizaj                              | 32 km    |
| 05  | Rruga Gjilan - Magjistralja Prishtinë – Shkup (Maqedoni)             | 30 km    |
| 06  | Rruga Gjilan - Prishtinë – Aeroport                                  | 60 km    |
| 07  | Rruga Gjilan - Lipjan – Aeroport                                     | 50 km    |
| 08  | Rruga Gjilan - Novobërdë   | 19.5 km  |

Po japim te dhenat e rrugeve qe Komunen e Gjilanit idhin me Maqedonin (Kumanoven) e cila po tentohet t  b het b het p rimes  rrug s regionale Gjilan- Zheg r - Stanqiq - Kumanov  dhe del n  magjistralen Beograd - Athin  gjegj sist  prek koridorin 8 dhe 10




Foto 3 : Harta rajonale para dhe pas procesit te decentralizimit

N  Komun n e Gjilanit  sht  nj  nd rmarrje transportuese publike dhe 21 kompani private transportuese si dhe 136 autotaksi .




Foto 4 : Rrug t kryesore n  Kosov 

- Hekurudhat

- Terminali hekurudhor për ngarkesa

Komuna e Gjilanit nuk ka hekurudhë, stacioni më i afërt i trenave është në Ferizaj 33 km larg, kjo nuk e pengon zhvillimin e komunës nga se rruga magjistrale Gjilan – Ferizaj ofron kushte te mira te transportimit te mallrave .



Foto 5. Hekurudhat në Kosovë

- Aeroportet

Aeroporti më i afërt është në Prishtinë rrreth 60 km larg nga Gjilani nëse shfrytëzohet magjistralja Gjilan – Prishtinë – Aeroport dhe rrreth 50 km nëse shfrytëzohet magjistralja Gjilan – Lipjan – Aeroport , po ashtu ka edhe aeroportin e Shkupit 80 km .

Aeroportet kan lidhje dhe linja te mirat me te gjitha shtet si ato ne perëndim dhe ne lindje, po ashtu aeroporti ndërkontinentale ofron shërbime për pasagjere dhe shërbime kargo .



- Rugët ujore të lundrueshme

Rugët ujore që lidhin Komunën e Gjilanit është Deti Adriatik gjegjësisht porti i Durrësit (320 km) dhe i Shëngjinit (290 km) të cilat ofrojnë shërbime të mira nga se janë porte me ujët të thellë për bartësit e ngarkesave, po ashtu Komuna e Gjilanit është pjese integrale e rrugës se kombit (autostrades) Prishtinë – Tiran – Durrës

## **Komunalet (lista e ofruesve dhe të gjitha informatat në dispozicion në lidhje me komunalet)**

- Rrymë elektrike :

Në komunën e Gjilanit ekzistojnë 4 TS 35/10 kv : Gjilani I deri Gilani IV dhe Lladova, 24 km lidhje koblloviqe dhe 347 km lidhje ajrore me gjithsejt 3476 shtylla elektrike dhe 271 trafostacione 10/0.4 kv, me gjithsejt 57 MVA fuqi instaluese 35/10(Kv) dhe 51.5 MVA fuqi instaluese Ts 110/35 (KV).

Duke iu falenderuar donatorëve, komuna e Gjilanit ne mase te mdhe po e përmirëson infrastrukturën energetike, tani eshte duke u nderuta trafostacioni Gjilani V si donacion i ardhur nga Qeveria e Zvicrës , trafostacioni i ri do të përmirësojë furnizimin me energji elektrike dhe perfundimisht Gjilani i thot lamtumire terrrit dhe ngarkesa në trafostacione në sezonin dimërор, pra Korporta Elektro Energetike e Kosoves ne bashkekordinim me Komunen ka arritur për t'u ofruar shërbime më kualitative per qytetare dhe biznese .

- Telekomunikimi (mobil, i të dhënavë, telefon, etj.)

Në Gjilan vepron Njësia e Postës dhe Telekomit të Kosovës ku kapaciteti i telefonisë fikse është i mjaftueshmë dhe eshte ne rritje, brenda dites sigurohet nje numer i telefonise fikse nga se pas luftes eshte punuar shume ne modernizimin e teknologjisë informative, po ashtu ekzistoje edhe telefonia mobile Vala 900 dhe IPKO te cilat ofrojnë shërbime te telefonise dhe internetit me kapacetet te mjaftueshm .

- Burimet e ujit dhe disponueshmëria e përgjithshme me ujë

- **Madhësia e ujësjellësit :** Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit është mbi 100 km, me dimensione është 050- 0 400, jo vetem qyjeti por edh te gjitha fsahtarat e mdha janë te kyqyrat ne rrejtin e ujesjellsit, me menaxhimin e burimeve te ujit, rrejteve te ujesjellsit menaxhon Ndermarrja Publike "Hidromorava"
- **Ujësjellësi në dispozicion :** Kapaciteti maksimal i prodhimit është 300 l/s, Komuna e Gjilanit furnizohet me uje te pijeshme nga keto burime : penda në fshatin Përlepnicë ku ekziston edhe fabrika e perpunimit te ujit, lokacioni Guri i Hoxhës, lokacioni Baja dhe Velekica ku ekziston edhe fabrika e perpunimit te ujit, po ashtu vlen te ceket se ekziston edhe rrjeti i ujesjellsit industriale ku jan furnizuar me uje fabrika e Tekstilit, Baterive, Çeliku, Radiatoret etj. po ashtu ekziston edhe Penda e Livoqit e cila momentalisht shfrytzohet per rekreacion .



Foto 6. foto Penda

- **Kanalizimi dhe impiantet për trajtim të ujërave të zeza**
  - **Kërkesat për shkarkim të kanalizimit :** Me sistemin e kanalizimit të ujrale fekal është i mbuluar i gjithe territori i komunes se Gjilanit ne perjashtim viset e thella malore, me menaxhimin e rrejtit te kanalizmit menaxhon Ndermarrja Publike "Hidromorava"
  - **Kapaciteti i trajtimit të ujërave të zeza :** një pjesë e rrjetit të kanalizimit të ujrale atmosferik është i kyqur në atë të ujrale fekal, vlen te ceket se per momentin nuk ka fabrika te trajtimit te ujrale te zeza, ku sot ekipet e ingjinerive dhe planerve po punojne qe shume shpejte te ndodhe nje gje e tille, po shikohet mundesia qe nje investim i tille te ndodhe permes Parteriteti Publiko Private, ku komuna e Gjilanit i ka hapure rruge ketij procesi .
- **Hedhja e mbeturinave**
  - **Mbeturinat e përgjithshme :** ne Gjilan ne fshatin Velekicë (5km) ndodhet deponia Regionale, lokacioni i qëlluar larg vendbanimit , i përgaditur mire për deponim të hedhurinave, kjo deponi ndryshon dukshëm nga deponia e vjetër sepse janë marrë parasysh kushtet gjeologjike, hidrologjike, topografike, deponia ofron kushte per menagjim të kontrolluar të hedhurinave, mbulim të përditshëm të hedhurinave me shtresë dheu, pengesë kundër ndotjes së ajrit, ujërave nëntokësore ujërave sipërfaqsore, trajtim të ujërave kulluese dhe gazërave nga dekompozitimi i hedhurinave, me menaxhimin e mbeturinave menaxhon Ndermarrja Publike "Higjiena" ku si aktivitet primare ka grumbullimi, bartjen dhe deponimin e mbeturinave ne komunat ku vepronë .
  - **Riciklimi :** deri tani shume here është diskutuar për mundësin e riciklimit te mbeturinave / letres dhe plastike /, deri tani nuk ka pas iniciative as individuale e as institucionale tani komuna e Gjilanit ka hyre ne Parteriteti Publiko Private te ndermarrjes publike per grumbullimin e mbeturinave "Higjiena"e cila parashifet ky procese ku ne amse te madhe do te zvoglonte sasin e mbeturianve ne deponi dhe do te krijonte vedne te rja pune, ne Gjilan ekzistojne disa ndermarrej private te grumbullimit te metaleve – hekurit edhe elementeve tjera metalike .



*Foto 7. foto deponia dhe riciklimi i mbeturinave*

- **Mbeturinat e rrezikshme :** me menaxhimin e mbeturinave menaxhon Ndermarrja Publike "Higjiena" ku si aktivitet primare ka grumbullimi, bartjen dhe deponimin e mbeturinave ne komunat ku vepronë, ketu perfshihien edhe deponimi i mbetrinave te rrezikshme .

## Punëdhënësit kryesor / Ekonomia

- Lista e dhjetë punëdhënësve kryesor në komunë, çfarë prodhojnë/shesin/etc., dhe punësimi i përgjithshëm nga secila kompani

**Sektori shoqëror :** po përballet me shumë probleme për shkak të humbjeve të mëdha gjatë periudhës së okupimit (në dekadën e kaluar), por gjithashtu edhe për shkak të transformimit ekonomik pas luftës në Kosovë, pra pas vitit 1999. Pengesat kryesore janë: mungesa e kapitalit qarkullues, sigurimi i lëndës së parë, mungesa e investimeve, humbja e tregjeve, etc. Shpresa e vetme për sektorin shoqëror të ekonomisë eshte mbete privatizimi i ndërmarrjeve. Ekzistojnë investorë potencialë lokalë dhe ndërkombtar të interesuar për të investuar në privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ky process eshte ne perfundim e siper dhe po menaxhohet nga Agjencia Kosovare i Privatizimit, <http://www.pak-ks.org/>

**Sektori privat :** në Gjilan daton kryesisht nga fundi i viteve të tetëdhjetë (1989), duke u zhvilluar intensivisht gjatë katër viteve të fundit. Sot, ekzistojnë 3737 ndërmarrje që janë të regjistruara dhe funksionojnë në Gjilan, duke punësuar më shumë se 10,000 punëtorë. Më shumë se 75% e ndërmarrjeve private të regjistruara janë të angazhuara në aktivitete tregtare, duke punësuar më shumë se 63% të numrit total të të punësuarve në sektorin privat. Vetëm 3.5% e ndërmarrjeve janë të angazhuara në krijimin e vlerës së re – në prodhim. Këto ndërmarrje kryesisht importojnë nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, Turqia, Greqia, dhe nga vende të tjera Europiane.

### Ndërmarrjet Ndërtimore :

Përkundër sfidave të sektorit të ndërtimitarisë në pothuajse secilin sektor, ekziston një numër i faktorëve pozitiv dhe i mundësive, pas luftes hovi i vazhdueshëm i tregut eshtë një prej faktorëve më të rëndësishëm, deri në 80% të materialeve ndërtimore dhe produkteve të përdorura në ndonjë projekt janë të importuara disa nga firamt ndërtimore kan gryrehyse te cilat me investimenti e tyre kan aritur te sigurojne lenden e pare per rregullimin e rrugeve dhe rere te kulitetit te larte per ndërtim me gjithat aktualisht nuk ka laboratorë të akredituar të pavarur për testimini e materialeve në Kosovë.

#### *Listë e ndermarrjeve ndërtimore :*

| Nr. | Emri i biznesit        | Lokacioni       | Te dhena tjetra – veprimatria                                      |
|-----|------------------------|-----------------|--|
| 01  | Company Bejta Commerce | Gjilan – Gllama | <a href="http://www.bejta-commerce.com">www.bejta-commerce.com</a> |
| 02  | Tali                   | Gjilan          | Stabilimente te betonit dhe asfaltim te rrugë                      |
| 03  | Magjistralja           | Gjilan          | Asfaltimi i rrugëve  |
| 04  | EuroTrans              | Gjilan          | <a href="http://www.eurotrans-ks.com">www.eurotrans-ks.com</a>     |
| 05  | Agrohermes             | Gjilan          | <a href="http://www.agro-hermes.com">www.agro-hermes.com</a>       |

### Ndërmarrjet Prodhuese :

Ekzistojne një numer i vogel i ndermarrjeve prodhuese, kryesihste ato janë te orientuara ne keto lemi : prodhimi i ujit, pijeve freskuese, lengjeve te ndryshme si dhe perpunimi i pemave .

#### *Listë e ndermarrjeve prodhuese private :*

| Nr. | Emri i biznesit        | Te dhena tjetra – veprimatria  |
|-----|------------------------|--|
| 01  | Company Bejta Commerce | Prodhimi i ujit "Ola"  |
| 02  | Compact Group          | Prodhimi i ujit "Dea"  |
| 03  | Compania Fluidi        | Prodhimi pijeve freskuese dhe lengjeve te ndryshme   |
| 04  | Compania ASK Foods     | Prodhimi i produkteve ushqimore bio / <a href="http://www.ask-foods.com">www.ask-foods.com</a> |

**UJË NATYRAL - MINERAL “OLA”** : Fabrika për prodhimin e ujit natyral-mineral dhe të gazuar “OLA” punën e filloi më 8 shtator 2002. Uji natyral-mineral “OLA” buron nga thellësia e tokës së Kosovës. Burimin e ka nga një masë shkëmbore në thellësi prej 48 dhe 58 metra. Uji i këtyre dy burimeve është i analizuar dhe i testuar dhe si i tillë i plotëson të gjitha standartet e ujit të pijshëm.




Company Bejta Commerce : [www.bejta-commerce.com](http://www.bejta-commerce.com)

**UJË NATYRAL - MINERAL “DEA”** : Ujë Natyral Mineral DEA i nxjerrur nga thellësia e nëntokës në bjeshkët e Zhegocit është një nga ujërat më të lehta oligo minerale dhe posedon një sasi të mjaftueshme të mineraleve që jan të domosdoshme përfunksionimin e trupit dhe stabilizimin e tij. DEA ka filluar prodhimin në vitin 2004. Në dy vitet e para, kompania me sukses ka hyrë në treg dhe ka nje rritje rapide në treg. Kjo ishte nga shkaku i cilësisë së mirë të ujit të prodhimit si dhe nga promovimi adekuat i qëllimit.



Compact Group : [www.ujidea.com](http://www.ujidea.com)

**Kompania Fluidi** : tashmë është njëra ndër kompanite udhëheqëse dhe më të mëdha në Kosovë dhe regionin e Ballkanit, duke prodhuar pije natyrale dhe të gazuara me licencë ndërkombëtare. Falë profesionalizmit të lartë në punë dhe pajisjeve më moderne, kompania jonë është e certifikuar me ISO standartet përführim me praktikat e mira. Këtë e dëshmon edhe fakti që tanimë jemi prezente në më shumë se 10 shtete europiane.



[www.flidi.net](http://www.flidi.net) & [www.rccola-f.com](http://www.rccola-f.com)

### **Ndërmarrjet Shërbyese dhe Qendrat Tregtare :**

Ekzistojne një numer i madhe i ndermarrjeve shërbyese, sipas satastatikave 80% te ndermarrejeve te regjistruara jane ndermarrje shërbyese, ku kryesisht importojen produktet e tyre nga vendet fqinje, po ashu kemi edhe disa qendra tregtare te cilat kane te punuar një numer relativisht te madhe ne kete sektore , ekzistojen disa qendra theatre por mete njojurat jane : Agmia Center, Drini Market, Viva Market, ETC, Bezi Market, Florimi Center, .....

**Agmia Center :** Lokacioni i Agmia Center gjendet në magjistralen Gjilan-Bujanoc, Agmia Center ka një sipërfaqe të ndërtimit mbi 12000 m<sup>2</sup> si qendër tragtare si dhe objektet tjera që hyjnë në kuadër të Agmia Center mbi 4500 m<sup>2</sup> objekte të shfrytëzuara, në kompleksin e Agmia Center veprojnë mbi 54 biznese private. Sipas analizave të stafit të Qendres Tregtare Agmia Center Numri i vizitorve gjatë ditës arrin deri në 3500-4000 vizitorë, ndërësa gjat sezonit arrin deri në 8000 vizitorë në ditë, Në Agmia Center - janë të punësuar mbi 200 punitore të profileve të ndryshme, per me shume informata [www.agmia-center.com](http://www.agmia-center.com)

**Ndërmarrja Diamond :** u themelua në vitin 1999 ku filloi furnizimin e tregut kosovar me produktet për nevoja shtëpiake të firmës së njojur turke PASABAHÇE, me një numër të madh produkteve nga qelqi. Në kuadër të zgjerimit të aktivitetit, në vitin 2004 ndërmarrja Diamond fillon me shpërndarjen në tregun kosovar të një artikulli shumë të nevojshëm nga kompania e njojur turke PAKSEL: pelena për fëmijë DIANA, në vitin 2005 ndërmarrja Diamond sjell në Kosovë edhe dy produkte tjera higjenike me kualitet edhe më të lartë: pelenat për fëmijë me mbështjellës tekstile VIP Baby dhe vatat për femra DIANA, per me shume informata [www.diamond-ks.com](http://www.diamond-ks.com)

### **Industria /Ekonomia**

- Kompanitë ekzistuese prodhuese :** Deri në vitet e 90-ta, Gjilani kishte një ekonomi relativisht stabile, ajo përbëhej prej Kombinati i Tekstilit, Kombinati i Duhanit, Fabrika e baterive, Fabrika e Radiatorve, Çeliku, Grafikos, Elektrokosova, Morava e Binçës, Kosovatransi, PTK, Agrokultura, Veterinaria, Stacioni i Bujqësisë, Mirusha , Ekonomia e Pyejeve, 28 Nëntori, Anamorava, Qarkullimi, Teuta, Kristali, Drita, Hidroteknika, Ndërmarrja Komunale Publike, Kualiteti, Hekurishtja. Mirpo shfrytëzimi dhe administrimi jo i drejtë i këtyre kapaciteteve, gjatë dhjetë viteve të kaluara, periudhë kjo kur shqiptarët ishin privuar nga e drejta e punës, kanë bërë që riaktivizimi i tyre të jetë i vështirë. Shumica nga keto fabrika janë privatizuar nga Agjencia Kosovare i Privatizimit(<http://www.pak-ks.org/>) mirepo disa prej tyre ende mbeten ne kete procese si qe eshte Fabrika e Radiatoreve e cila menjher nga pas lufta ka rifilluar prodhimtaria .

*Listë e ndermarrjeve prodhuese – industria*

| <b>Nr.</b> | <b>Emri i biznesit</b>           | <b>Te dhena tjetra – veprimtaria</b>                         |
|------------|----------------------------------|--|
| 01         | Fabrika e Radiatoreve "Jugoterm" | <a href="http://www.jugoterm-ks.com">www.jugoterm-ks.com</a> |




- Përfshijë prodhimet që prodhohen nga kompania dhe Lokacioni i selisë së korporatës : Fabrika e radiatorëve dhe e stabilimenteve klimatike ka filluar punën në vitin 1978 dhe me prodhimet e saj ka arritur të depërtojë edhe në tregun e jashtëm. Prodhimet e kësaj Fabrike janë: radiatorët për ngrohje qendrore, radiatorët elektrikë (me vaj), radiatorët gypor, kolektorët solarë, kaldajat K-30 , makinat ftohëse për transformatorë. Me këtë prodhimtatri, Fabrika e Gjilanit ka qenë e pranishme në tregjet e ndryshme të botës, si në Irlandë, Spanjë, Zvicër, Gjermani, Greqi, Libi e të tjera. Radiatorët prodhohen në teknologji bashkëkohore, sipas licenës së firmave "FAEL" të Zvicrës dhe "MUHR" të Gjermanisë. Arrijnë nivel ideal të ngrohtësisë, kanë pamje dhe domenione standarde dhe janë të përshtatshëm për t'u vendosur në çdo ambient. Garancioni i tyre është 15 vjet. Fabrika gjendet në rrugën "Mulla idrizi", nr 26 në Gjilan.

**Ekonomia joformale** – deri ne vitin 2010 një numër personash me zeje të ndryshme si elektricistë dhe shërbime ndërtimore, floktari, rrobaçepësi, e kështu me rradhë kan ushtruar aktivitetin e tyre pa regjistrim biznesi, me themelimin e Qenderes per Regjistrimin e Biznesit ne Gjilan, Komuna ka bërë përpjekje dhe ka bindur të regjistrohen, tanë më ekonomia jo formale nuk ekziston, deri ne vitin 2010 Regjistrimi i Biznesit ishte i centralizuar dhe kjo krijonte probleme per nivelin lokal .

## Zonat industriale

- Pasqyra e zonave industriale/parqeve/vendndodhjeve/ndërtesave të lira në komunë Komuna e Gjilanit në bazë të planeve rregulluese dhe strategjisë zhvillimore ekonomike ka identifikuar disa zona të lira të cilat i hapin rrugë perspektives zhvillimore ekonomike, me gjithat ne mungese te mjeteve buxhetore nuk kemi arritur te funksionalizojm me infrastrukturë asnjë njëren nga këto, viti 2012 dhe vitet ne vijim do ti kushtohet një rëndësi e veçanet këtyre zonave . Ministria e Tregtise dhe Industrisë do te jete mbështete e këtyre proceseve te krijuar te zonave ekonomike .



Plani Zhvillimor Urban dhe Komunal dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë : <http://www.mti-ks.org>

Zona industriale do të mundësoj një impuls të ri për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme ku do tu mundësoj bizneseve sipërfaqe të urbanizuara me infrastruktur moderne për zhvillimin e aktiviteteve në rend të parë atyre prodhuese .

## PERKRAHJE KOMUNAVE PËR KRIJIN E ZONAVE EKONOMIKE NË KOSOVË

Ekonomi

Economy


- Përgatit listën me tiparet e poshtme për çdo zonë industriale/park/lokacion/ndërtesë të lirë në komunën tuaj

(Karakteristikat e përgjithshme, Madhësia e lokacionit, Qasja e transportimit në magjistrale dhe rrjeti rajonal i transportit, Përfshini harta, plane të ndërtesave, fotografi, fotografi ajrore)

**Zona e parë :** Komuna e Gjilanit dhe Komuna e Novobërdës janë pajtuar që të hyjnë në partneritet të përbashkët në pajtim me ligjin për vetëqeverisjen lokale që të krijojnë një zonë të përbashkët ekonomike e cila gjendet në territorin e Komunës së Novobërdës në Llabjan e cila ka dalje në rrugën regionale Gjilan – Prishtinë dhe rrugën rajonale Prishtinë – Novobërdë – Kamenicë – Ranilluk Dheu i bardhë.

Zona e përbashkët ekonomike gjendet në zonën kadastrale – Novobërdë, Nr. i njësisë P-72414040-00627-0, lloji i pronës parcelë, Në vendin e quajtur Koznica me sipërfaqe prej 693409m<sup>2</sup>.

Gjilan/Gnjilane



Zona e ekonomike – e planifikuar sipas vendimeve të Kuvendeve Komunale Gjilan dhe Novobërdë

## VIZIONI

The Municipality of Gjilan will have efficient local governance with regulated urban and rural infrastructure and a clean and healthy living environment.

The strong tradition of industry and entrepreneurship will result in rapid SME development and an increase in employment.

Good cross-border cooperation will enable a better integration of regional economies and will create a favorable environment to attract investors.

Komuna e Gjilanit do të ketë geverisje lokale efikase me infrastrukturë të rregulluar urbane dhe rurale, do të jetë një mjedis i shëndoshë dhe i pastër për jetesë.

Tradita e fortë industriale dhe e ndërmarrësishë do të shprehet me zhvillim të fuqishëm të NVMve dhe rritje dinamike të punësimit.

Bashkëpunimi i mirë ndërkufitar do të mundësojë integrimin e ekonomisë së rajonit dhe krijimin e ambientit për tërheqjen e investitorëve.



Vizioni i Komunës se Gjilanit dhe Zona ekonomike në raport me shtet fqinje Serbi dhe Maqedoni

**Zona e dytë :** Komuna e Gjilanit edhe deri tani është dëshmuar e suksesshme në projektet e këtilla dhe ajo i vlerëson si shumë të nevojshme bashkëpunimin reciprok dhe krijimin e lidhjeve midis institucioneve të ndryshme, të cilat po japid kontribut në nxitjen dhe stimulimin e zhvillimit ekonomik .



Zona industriale do të mundësoj një impuls të ri për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme ku do tu mundësoj bizneseve sipërfaqe të urbanizuara me infrastruktur moderne për zhvillimin e aktiviteteve në rend të parë atyre prodhuese . Bizneset potenciale që janë duke kërkuar mundësit e një biznesi të zhvilluar modern në boten e globalizuar e cila është në rritje e sipër për të hapur dyer të vizioneve të reja bashkëpunimeve dhe lidhjeve ndërkombëtare dhe dhënjes së shërbimeve të tjera do të kenë mundësi të arrin të gjitha këto më lehtë në zonën industriale . Zona industriale shtrihet në sipërfaqen prej S=142,640 m<sup>2</sup> (14,264 ha)

**Zona e tretë :** Komuna e Gjilanit dhe Komuna e Parteshit krijimin zonave ekonomike e kan parpare se do te kete keto përfitime : Krijimi i bazës së qëndrueshme për realizimin e objektivave tona zhvillimore, Përmirësimi i rrëthinës afariste, Nxitë zhvillimin e biznesit privat, Krijon mundësi për rritjen e interesimit për investime në sektorin privat nga donatorët(për shkak të pozitës ideale për këtë lloj biznesi), Përqendron prodhuesit industrial në një zonë me infrastrukturë të rregulluar(përbashkët), Favorizon krijimin e ndërmarrjeve të reja industriale (duke marrë parasysh se Gjilani ka traditë dhe resurse të mjaftueshme), Krijon mundësi për thithjen e kapitalit nga diaspora (për shkak të parakushteve mjaft të mira) dhe Krijimi i vendeve të reja të punës. Zona e konomike ne fshatin Pasjan perfshin parcelat me numra 3402 dhe 3403 .



## Stimulimet

- Stimulimet e përgjithshme që mund të ofrohen nga komuna për industrinë/biznesin e kualifikuar (të mos ketë hollësi të tepruara)

Bashkëpunim i Komunës se Gjilanit me Komunitetin e Biznesit është ne nivel shumë te larte vlen te ceket bashkëfinancimi i projektit : Ndërtimi dhe instalimi i largpërçuesit kabllovik 20 KV nga trafostacioni 35/10 /20/ KV Gjilani 4 deri te Kompania Bejta Commerc – rruga për Ferizaj, kjo zone më heret është përballurë me probleme të shumta dhe humbje të mëdha në bizneset e tyre për shkak të reduktimeve te energjisë elektrike. Iniciativa e komunitetit të biznesit për të eliminuar këtë problem dhe këto humbje në bizneset e tyre ka marrë pëlqimin dhe mbështetjen e Komunës për participim në këtë projekt në mënyrë që këtij komuniteti të biznesit t'iu garantojë furnizim 24 orë me energji elektrike.

Po ashtu edhe pjesa e rrugës së Bujanovcit, me iniciativë të tyre dhe në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, zyrës së USAD-it dhe KEK-ut dhe Komunës së Gjilanit kanë finalizuar një projekt i tillë dhe quhet kategoria A+, financimi i këtij projekti në masë të madhe do t'i zbuste problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti i biznesit, njëherit ka krijuar kushte të mira dhe mundësi të krijimit të vendeve të reja të punës .

Po ashtu vlen te ceket edhe bashkëpunim i Komunes se Gjilanit me Shoqaten e Argjentarave , ku janë financuar projekti i : Ndërtimi i qendrës zejtare (afër objektit të Xhamisë së Madhe), ku janë soiguruar lokale afariste për 32 zejtare .

## Fuqia punëtore / papunesia

- Karakteristikat e fuqisë punëtore, Fuqia punëtore totale, Shkalla e papunësisë, Kualifikimet e përgjithshme të punëtorëve në zonën tuaj ; Paga mesatare për kategorinë kryesore të kualifikimit ; Kategoria kryesore e kualifikimit në zonë :

| Tregu i Punës në Komunën e Gjilanit SHKURT 2011  | Qendra Regionale për Punësim Gjilani |      |                   |       |        |       |          |       |
|--|--------------------------------------|------|-------------------|-------|--------|-------|----------|-------|
|  | Gjilan Gjithsejt                     |      | Komuna e Gjilanit |       | Viti   |       | Kamenicë |       |
|  | Shifra                               | %    |                   | %     | Shifra | %     | Shifra   | %     |
| Numri i punëkërkuesve të rinjë t' regjistruar gjatë muajit aportues                              | 218                                  | 100  | 113               | 100.0 | 79     | 100.0 | 26       | 100.0 |
| Numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në fund të muajit raportues sipas strukturës kualifikuese   | 34832                                | 100  | 21817             | 100   | 5797   | 100   | 7218     | 100   |
| të pakualifikuar   | 19408                                | 55.7 | 12142             | 56    | 3093   | 53.4  | 4173     | 57.8  |
| gjysëm të kualifikuar  | 1783                                 | 5.1  | 1383              | 6     | 224    | 3.9   | 176      | 2.4   |
| të kualifikuar   | 2432                                 | 7.0  | 1700              | 8     | 505    | 8.7   | 227      | 3.1   |
| me shkollë të mesme  | 10441                                | 30.0 | 6036              | 28    | 1861   | 32.1  | 2544     | 35.2  |
| me shkollë të lartë  | 257                                  | 0.7  | 197               | 1     | 29     | 0.5   | 31       | 0.4   |
| me fakultet  | 511                                  | 1.5  | 359               | 2     | 85     | 1.5   | 67       | 0.9   |
| Numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në fund të muajit raportues sipas grup moshës               | 34832                                | 100  | 21817             | 100   | 5797   | 100   | 7218     | 100   |
| 16 - 24 vjeç   | 11863                                | 34.1 | 7191              | 33.0  | 2249   | 38.8  | 2423     | 33.6  |
| 25 - 39 vjeç   | 15965                                | 45.8 | 9854              | 45.2  | 2612   | 45.1  | 3499     | 48.5  |
| 40 - 54 vjeç   | 5665                                 | 16.3 | 3684              | 16.9  | 812    | 14.0  | 1169     | 16.2  |
| 55 +   | 1339                                 | 3.8  | 1088              | 5.0   | 124    | 2.1   | 127      | 1.8   |
| Numri i përgjithshëm i punëkërkueseve (FEMRA)në fund të muajit raportues sipas struk.kualifikuse | 16570                                | 100  | 10577             | 100   | 2654   | 100   | 3339     | 100   |
| të pakualifikuar   | 10997                                | 66.4 | 6811              | 64.4  | 1799   | 67.8  | 2387     | 71.5  |
| gjysëm të kualifikuar  | 657                                  | 4.0  | 492               | 4.7   | 108    | 4.1   | 57       | 1.7   |
| të kualifikuar   | 518                                  | 3.1  | 412               | 3.9   | 98     | 3.7   | 8        | 0.2   |
| me shkollë të mesme  | 4039                                 | 24.4 | 2555              | 24.2  | 619    | 23.3  | 865      | 25.9  |
| me shkollë të lartë  | 121                                  | 0.7  | 110               | 1.0   | 4      | 0.2   | 7        | 0.2   |
| me fakultet  | 238                                  | 1.4  | 197               | 1.9   | 26     | 1.0   | 15       | 0.4   |
| Numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në fund të muajit raportues sipas struk.nacionale           | 34832                                | 100  | 21817             | 100   | 5797   | 100   | 7218     | 100   |
| Shqiptar   | 30251                                | 86.8 | 19641             | 90.0  | 5084   | 87.7  | 5526     | 76.6  |
| Sérbi  | 3605                                 | 10.3 | 1306              | 6.0   | 709    | 12.2  | 1590     | 22.0  |
| të tjera   | 976                                  | 2.8  | 870               | 4.0   | 4      | 0.1   | 102      | 1.4   |

Te dhenat jan marre nga Qendra Regional e Punesimit e cila eshte ne kuader te Ministrise se Punes dhe Mireqenjes Sociale, vizito : [www.rks-gov.net/mpms](http://www.rks-gov.net/mpms)

## Arsimi – shkollat/programet teknike/universitetet

- Shkollat për fëmijë – publike dhe private
  - Lloji i shkollave : te gjitha shkollat ne Komunen e Gjilanit jane publike,
  - Numri i shkollave : Komuna e Gjilanit ka 44 objekte shkollore duke perfshire arsimin fillor dhe te mesem, vetem ne qytet ka 8 shkolla fillore dhe 5 shkolla te mesme si dhe konviktin e nxensve dhe studenteve .



Çfarëdo shkolle speciale për arsim profesional/teknik : shkollat e mesme jane te pasijura me kuadro profesionale pastaj programe dhe laboratore te ndryshem si dhe pune praktike per nxense, tanë kemi keto shkolla te mesme : shkolla e mesme ekonomike, shkolla e mesme e bujqësisë dhe ambientit, shkolla e mesme e mjekesisë, gjimnazi dhe shkolla e mesme teknike . Sistemi shkollor i mesëm akoma nuk ofron trajnime praktike të majftueshme, por më shumë është i orientuar kah arsimimi i përgjithshëm në fushat e medicinës, makinerisë, bujqësisë, ekonomisë, etj.

Trajnimi profesional – Zyra Regionale e Punësimit dhe Qendra per Aftesim Profesional (e udhëhequr dhe financuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale) ofron trajnime të ndryshme në fushën e makinerisë, informatikës, zdrukthtarisë, dizajnit, et., me qëllim të lehtësimit të punësimit të njerëzve të rinj. Keto zyre gjithashtu është e anagzhaur në ndërmjetësim të punësimit. Trajnimet profesionale janë me rëndësi të madhe duke patur parasysh që sistemi i mesëm i arsimit në Gjilan nuk është i orientuar në mënyrë adekuate kah trajnimi professional i nxënësve të shkollave të mesme me qëllim që ata sa më lehtë të gjejnë punë. Disa organizata tjera jo-qeveritare të cilat ishin të financaura nga organizatat ndërkombëtare kane qenë të angazhuara në trajnimin e grave në rrobaqepësi dhe disa zeje tjera.

Po ashtu ne Komunen e Gjilanit kemi edhe **QENDRA SOCIALE - EDUKATIVE "DON BOSKO "** e cila shërbenë për edukim, aftësim profesional dhe rekreacion për të rinjtë e Gjilanit, pa përjashtim.

- Shkollat teknike (në komunë apo rajon)
  - Lloji i shkollave te mesme :

| Gjilan | Gjimnazi "Zenel Hajdini"                  | Shkolla e mesme teknike "Mehmet Isai" | Shkolla e mesme e mjeksisë "Asllan Elezi" |
|--------|---|---------------------------------------|---|
|        | Shkolla e mesme ekonomike "Marin Barleti" | Shkolla e mesme e Bujqësisë "Arbëria" |   |

Për shumicën e nxënësve të komunës së Gjilanit, të cilët i kanë mbaruar klasat e nënta, gjimnazi ka qenë shkolla më e preferuar për regjistrim.

- Kohëzgjatja e programeve : është 3 dhe 4 vite

- Universitetet dhe kolegjet (në komunë apo rajon)

Gjate vitit 2009/2010 është përfunduar fizibiliteti për themelimin e Universitetit Publikë në Gjilan e cila si prioritet ka edukimin cilësor dhe nëpërmjet edukimit shtetndërtimin e suksesshëm dhe hapjen e perspektivës së vazhdueshme për këtë region e cila ka popullatë të re dhe traditë në arsim të lartë, Participimi në projekt për rregullimin e infrastrukturës : "Ndërtimi i amfiteatrit për nevoja të Fakulteteve të UP-së në Gjilan", nga ana e Kuvendit Komunal të Gjilanit dëshmon se implementimi i këtij projekti është pjese integrale e Strategjisë për Zhvillimin Arsimit ë Lartë, tanj Universiteti Publikë në Gjilan ka rrithë 4.500 studente te drejtimeve juridikë, ekonomik dhe fakultetit të edukimit .



#### **Po ashtu në Komunën e Gjilanit kemi edhe dy fakultete private :**

- a) **Degën e Kolegit "Fama"** - Kolegji "FAMA", i themeluar në Kosovë si institucion privat i arsimit të lartë është i angazhuar në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimeve shkencore dhe ka disa objektiva të cilat janë të shënuara në Statutin e Kolegit "FAMA". Kolegji "FAMA", në gjithë veprimtarinë e tij, ka për mision të kontribuojë në zhvillimin e Arsimit të Lartë, arsimimin cilësor universitar dhe pasuniversitar në fusha të ndryshme profesionale, edukimin me vlerat më të mira morale dhe zhvillimin e kërkimit shkencor me qëllim që të sigurojë praninë e specialistëve të aftë profesionalisht dhe të pastër moralisht, që mund të shpien përpara procesin e zhvillimit ekonomik e shoqëror ne Kosovë, për me shume informata : <http://www.kolegijfama.eu/gjilani>
  - a. Programet e ofruara : Menaxhment, Banka, Financa dhe Kontabilitet, Juridik, Kriminalistikë, Shkenca Politike dhe Administratë Publike, Psikologji, Sociologji,
- b) **Kolegin Universitar "Gjilani"** : është i themeluar në Gjilan si institucion privat i arsimit të lartë është i angazhuar në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimeve shkencore, për me shume informata : <http://kugjilani.org> . Sipas vendimit të Bordit Drejtues të Kolegit Universitar "Gjilani", për maturantët shembullor kanë ndarë 20 bursa për ata nga Komuna e Gjilanit, 10 për Komunën e Vitisë dhe 10 për komunën e Kamenicës.
  - b. Programet e ofruara : Menaxhment, Banka, Financa dhe Kontabilitet, Juridik, Kriminalistikë, Shkenca Politike dhe Administratë Publike, Psikologji, Sociologji, Gjuhë të huaja .

## Tatimet

- Struktura e përgjithshme tatimore në Kosovë : Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), është e përkushtuar në trajimin e barabartë të të gjithë tatimpaguesve, gjithashtu, ATK është e palëkundur në qëndrimet e saj në zbatimin e plotë të legjisacionit tativor, në mënyrë që të krijoj kushte më të mira për zhvillimin e biznesit në Kosovë, vizito : <http://www.atk-ks.org>
- Tatimet për biznes/kompani prodhuase : Sipas Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) kemi këto lloje tatimesh : Tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi të ardhurat e korporatave, tatimi i paragjykuar, dhe tatimi në fitim
- Çfarëdo tatimi i veçantë komunal : Në Komuna ekzistonë Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale e cila rregullore cakton lartesin e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbim publike komunale si dhe nevojat tjera për personat fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitete ekonomike dhe jetësore në Komunën e Gjilanit . Lartësia e taksave dhe ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen do të caktohen sipas drejtoreve përkatëse. vizito : [www.rks-gov.net/gjilani](http://www.rks-gov.net/gjilani)
- Diskutim i shkurtër i tatimeve personale sa i përket qytetarëve të huaj : Nuk ekziston rregullore apo ligje mbi tatimet personale për qytetaret e huaj .

## Pajisja me leje

- Kërkesat për pajisje me leje për industri/biznese : Në Komuna ekzistonë Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale e cila rregullore cakton lartesin e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime publike komunale si dhe nevojat tjera për personat fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitete ekonomike dhe jetësore në Komunën e Gjilanit, keto taksa jane vjetore dhe shkojn ne buxhetin komunal te cilat permes investiemve ju kthehen prape qytetareve
- Kostot & Afati kohor – sa kohë nevojitet për të marrë miratimet komunale

| 9.1. | Taksat për leje pune për ushtrimin e veprimtarive afariste dhe pranim teknik të lokaleve afariste: |                     |
|------|--|---------------------|
| N/r  | Shërbimet/aktivitetet, tarifat/ngarkesat dhe gjobat  | Lartësia e taksës € |
| 7.1  | Tarifat për leje pune për të gjitha veprimtaritë afariste  | 10.00               |
| 7.2  | Për lokalet afariste deri në 50 m <sup>2</sup>   | 30.00               |
| 7.3  | Për lokalet afariste prej 51 m <sup>2</sup> - 100 m <sup>2</sup>                                   | 50.00               |
| 7.4  | Për lokalet afariste mbi 100 m <sup>2</sup> deri në 500 m <sup>2</sup>                             | 150.00              |
| 7.5  | Për lokalet afariste prej 501 m <sup>2</sup> deri në 1000m <sup>2</sup>                            | 300.00              |
| 7.6  | Për lokalet afariste mbi 1000m <sup>2</sup>  | 500.00              |

Shenime tjera Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale :

- Bizneset afariste që operojnë në shumë lokacione me firmë dhe leje të njëjtë për secilin lokacion paguajnë 60% të tarifës bazë
- Të gjitha subjektet afariste të cilat veprojnë në territorin e komunën tonë, që selinë e kanë jashtë territorit të Komunës së Gjilanit, do të paguajnë 80 % nga tarifa bazë.
- Përjashtim nga neni 4.2 i kësaj rregulloreje bëjnë subjektet afariste që merren me shërbime postare, telefonike, bankare,sigurime të pasurisë e njerëzve.(paguajnë 100% të tarifave të kësaj rregulloreje)
- Nga taksat dhe ngarkesat lirohen këto zeje të vjetra: kacagjinjët, saraçët, briskagjinjët, amargjinjët, litarpunesit, përpunuesit nga druri (magje punuesit, punuesit e kutive për pajë të nusërisë), punuesit e shoshave, enëve dhe veglave muzikore dhe përpunuesit tradicional të lesht: qeleshepunuesit, xhemper punuesit, zhguna punuesit, qilim

punesit, çorap punuesit, përpunuesit e argjilës dhe filigranit, kallaj gjinjtë, farkëtarët , pushlarët dhe mbathtarët.

- Bizneset që punojnë me orar të shkurtuar paguajnë 60 % të tarifës bazë vjetore, që kanë lejen e punës dhe licencën nga Ministria.
- Nga taksat dhe ngarkesat lirohen apo bëhet revidimi i vendimit paraprak për bizneset që e kanë mbyllë veprimtarinë e tyre për shkaqe: të afarizmit negativë apo ato që kanë pësuar fatkeqësi të llojeve të ndryshme.
- Të drejtë nga neni 4.8, bizneset mund ta realizojnë nëse sjellin dëshmi si: certifikatën (vërtetimin) për shuarje të biznesit nga Ministria e Tregtise dhe Industrisë, procesverbalin nga Koorporta Elektroenrgjetike e Kosoves, zjarrfikësit, Policia e Kosovës, në raste të fatkeqësive të ndryshme.

Tarifat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, detyrimi bazë është për shfrytëzimin e  $m^2$ , sipas zonave të qytetit. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla, të përkohshme – sezonale, lëvizëse në të cilat kryhet veprimtaria (tregti, hotelieri) si dhe pajisjeve të caktuara teknike (gjeneratorë, bankomat) - tarifa mujore.

| Nr. | Pershkrimi i zones | Lartësia e taksës € |
|-----|--------------------|---------------------|
| 01  | Zona I për $m^2$   | 10.00               |
| 02  | Zona II për $m^2$  | 8.00                |
| 03  | Zona III për $m^2$ | 6.00                |

Pasqyra e kategorizimit të objekteve sipas destinimit, zonave, dhe çmimi për  $1m^2$  të bruto sipërfares/hapësirës për kushte urbanistiko - teknike, pëlqim urbanistik përkatësisht leje ndërtimi

### Zonat

| Nr.  | Pershkrimet e pozicioneve  | I     | II    | III   | IV    |
|------|--|-------|-------|-------|-------|
| 4.8  | Objekte banimi: (objekte kolektive, individuale, vikend shtëpizat)                                     | 12.00 | 8.00  | 6.00  | 4.00  |
| 4.9  | Objekte afariste:tregtare, hoteliere, zejtare, shërbyes, turistike,                                    | 20,00 | 15.00 | 10.00 | 5.00  |
| 4.10 | Objektet Bujqësore, punëtoritë prodhuuese-bujqësore; Plemet, koshat; hambarët, ahurit, e të ngjashme.  | -     | 8.00  | 4.00  | 2.00  |
| 4.11 | Terrenet sportive-fushat e sportit të hapura, objekte lojérash përfëmijë dhe të rritur dhe të ngjashme | 5.00  | 3.00  | 2.00  | 1.00  |
| 4.12 | Objekte për ekspluatimin e resurseve natyrore (erës, ujit, etj )                                       | 50.00 | 45.00 | 40.00 | 20.00 |
| 4.13 | Objekte të Pompave:  | 50.00 | 45.00 | 40.00 | 20.00 |
| 4.14 | Objekte të tipit montues të karakterit të përkohshëm (kioske, baraka etj ) mbi $12m^2$                 | 15.00 | 12.00 | 6.00  | 3.00  |
| 4.15 | Objekte lëvizëse- mobile-ambulatore, bankomate, etj.   | 20.00 | 15.00 | 10.00 | 5.00  |
| 4.16 | Reklama-pano, e të ngjashme mbi $6m^2$   | 20.00 | 15.00 | 10.00 | 5.00  |

- A kërkohen lejet mjedisore? – Po kerkohet per impiante, gurethyese dhe shfrytzimin e ujrale termale – minerale .
  - Cilat nivele të qeverisë kërkojnë lejet mjedisore? : Ministrie e Planifikimit Hapsinorë dhe e Mjedisit, vizito : [www.rks-gov.net/mphm](http://www.rks-gov.net/mphm)

- Cilat departamente janë të përfshira në procesin e dhënisë së lejes?

Departamenti Buxhetit dhe Financave, Departamenti i Inspeksionit dhe sherbiemt Publike

- Ku i gjen kompania dokumentet e nevojshme për tu pajisur me leje?

Mbrenda ketyre departamenteve : Departamenti Buxhetit dhe Financave, Departamenti i Inspeksionit dhe Sherbiemet Publike .

- A keni zyrë të vetme për të aplikuar për leje apo ndonjë person kontakti për bizneset të cilat kanë nevojë për këtë proces? (zakonisht, profesionistët për ZhEL)

Gjate vitit 2010, Hapet Qendra Komunale për Regjistrim të Bizneseve (QKRB) në Gjilan, që ka lehtesar afaristët e këtushëm, të cilët nuk kanë më nevojë të shkojnë në Prishtinë për të këtë qëllim, por se shërbimin mund ta kryejnë edhe në komunën e tyre. Decentralizimi i kompetencës për regjistrim të bizneseve nga niveli qendror në atë lokal, do të reflektohet pozitivisht te afaristët, sepse tash e tutje, ata nuk kanë nevojë të humbin kohë dhe të bëjnë më tepër shpenzime për të shkuar në Prishtinë, siç ka qenë deri tani. Pagesa për biznese të vogla, është 7 €uro, informata mbi biznesin, kërkesa dhe certifikata - gjithsej 4 €uro, për ndryshime paguhet taksa prej 7 €, për shuarje të biznesit - 5, ndërsa për korporata - 22 €uro. Qendra Komunale për Biznes, është hapur në kuadër të një projekti të MTI-së, i cili financohet nga Banka Botërore, në shumë prej 200 mijë € dhe implementohet në disa 22 qytete të Kosovës, për t'iu ofruar bizneseve mundësinë që, duke u regjistruar në komunat e tyre, të kursejnë kohë dhe shpenzime. Gjilani ka përfituar në fazën e pare.



**Qendra e biznesit**  
Biznes centar/Business Centre  
Gjilan/Gnjilane

Qendra e Biznesit eshte përgjegjëse për: Regjistimin e bizneseve të reja (Biznese Individuale, Ortakëri të përgjithshme, Ortakëri të kufizuar, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Shoqëri aksionare, Kompani të huaj, Ndërmarrje shoqërore, Ndërmarrje publike, Kooperativa bujqësore) pastaj Riregjistrimi i bizneseve të regjistruara si të përkohshme, Regjistrimi i Emrit Tregtar i cili mund të shfrytëzohet nga cilio lloj i biznesit; Regjistrimin e njësive punuese të bizneseve kosovare; Regjistrimin e njësive – përfaqësive të kompanive të huaja në Kosovë, Regjistrimi i ndryshimeve në informata të cilat kanë qenë të regjistruara me regjistrim të përkohshëm, istribuimi i certifikatave për bizneset e regjistruara, dhënja e shenimeve dhe vertetimi i kopjeve të dokumentacionit nga regjistri i biznesit, bashkëpunimi me Zyrën e statistikës, Administratën tativore Zyrat dhe Agjensionet .



Komisioni Evropian ka paraparë ta mbuloj tërë territorin e Kosovës me pesë Agjensione Rajonale për Zhvillim; Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan, me qëllim të zhvillimit ekonomik regional dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës.

- Partneriteti Publiko Privat, Inkubatori i Biznesit dhe Panairet

Preriteti Publiko Privat : Komuna e Gjilanit gjate vitit 2011 u ka hap rrugë investimeve publiko-private dhe ka filluar procedurat për partneritet publiko-privat, si mënyrë e re e investimeve, e cila krijon mundësi për zhvillim më të shpejt. Komuna e Gjilanit po hyn në një faze të re të zhvillimit, duke vlerësuar se lloj i investimeve përmes partneritetit publiko privat, është në radhë të pare interes i qytetarëve të Gjilanit dhe i perspektivës së tyre.

Fillimisht janë identifikuar gjashtë projekte, ku komuna synon të hyjë në partneritet publiko privat, dy prej tyre ku parashihen ndertimet e objekteve afarisë –banesor Jane kontraktuar dhe Jane ne fazën e ndetimit, ne kete faze te partneritet publiko privat eshte perfshire edhe Kompania Regional e Mbeturinave "Higjiena".

Ligji NR.03/L-090 mbi Partneritetet Publiko Private u ka hapure rruga ketyre investimve, Ligji ka qenë shumë i mirëseardhur dhe ka qenë i përkrahur nga komunitetit i biznesit si e vjetmja mënyrë që t'i rrisë shërbimet ndaj qytetarëve, përmes formave të tillë të partneritetit, Partneritetin publiko-privat, konsiderohet si një nga mundësitat më të mira të zhvillimit ekonomik nga se do të ndihmojë që në një të ardhme të afërt të kemi zhvillim më të hovshëm ekonomik.



*Inkubatori i biznesit*

Inkubatori i Biznesit : Komuna e Gjilanit ka një inkubator te biznesit (1000 m<sup>2</sup>) e cila ka 18 hapesira te cilat Jane ne shfrytëzim te bizneseve, sallen e trajnimit dhe hapsirat tjera te nevojshme per biznese.

Panairet : Nje pjese e komuniteti te biznesit ne Komunen e Gjilanit marrin pjese ne panairet e organizuara si ne nivel lokal, nacional dhe nderkombetare, e gjitha per arsyje se pjemarja ne panaire ka arritur të gjenerojë ide të reja dhe kreative bashkëpunimi në mes të të gjithë pjesëmarrësve duke i dhënë një shtytje të fuqishme dinamizimit të aktiviteteve ekonomike .

Ne komunen e Gjilanit organizohet panairi i mjaltit dhe produketve te bletarisë, ndersa ne nivel nacional brenda vitit ne Kosove organizohet keto panaire: Panairi i Edukimit, Panairi i Turizmit dhe Hotelerisë, Panairi i Ndërtimit, Teknikës, Energjetikës dhe Mobilerisë, Panairi i Teknologjisë Informative, Telekomunikacionit dhe Grafikës, Panairi i Mjekësisë dhe Farmaceutikës, Panairi i Agrobiznesit dhe Ushqimit, Panairi i Pijeve, Panairi i Automobilistikës, Panairi i Institucioneve Financiare dhe Sigurimeve, ne keto panaire marin pjese jo vetem biznesest Kosovare por edhe nga shtetet fqinje dhe Evropa, vizito web faqen : [www.kosovafair.com](http://www.kosovafair.com) ose [www.ceokos.com](http://www.ceokos.com)

## **Informatat komunale**

- **Forma e qeverisë; tregoni edhe rreth qeverisë rajonale**

Ne vitin 2005, Komuna e Gjilanit është fiton çmimin “Diploma Evropiane”, shpërblim ky i Këshillit të Evropës për komunat ose kolektivitetet teritoriale, veçanërisht aktive në promovimin e idealit evropian. “Diploma Evropiane” është njëri nga katër çmimet më të larta që ndan Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës .



Çmimi i Evropës është themeluar në vitin 1955 si inkurajimin përvendosjen e marrëdhënieve më të mira në mes të gjithë qytetarëve të Evropës dhe në promovimin e idesë evropiane dhe asokohe, askush nuk mund ta imaginonte suksesin që do ta ketë. Deri në vitin 2000, me këtë çmim janë shpërblyer 56 qytete evropiane, 123 të tjera me plaketën e nderit, 900 kolektivite me flamurin e nderit dhe më shumë se 400 komuna janë laureate të diplomës evropiane.

- **Kryetari i komunës – qe sa kohë është në këtë post :**

Në bazë të nenit 12.2 dhe 12.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008), Kuvendi i Komunës në Gjilan në mbledhjen e mbajtur më datën 21.11.2008, miraton: **S TA TUTIN E KOMUNËS SË GJILANIT**

Komuna e Gjilanit është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

Organet e komunës janë:

1. Kuvendi i Komunës është organ më i lartë i Komunës dhe
2. Kryetari i Komunës është organi më i lartë ekzekutiv i komunës.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë, i cili zgjedhet në mënyrë të

Drejtpërdrejtë nga qytetarët (ne mandate 4 vjeqar) në pajtim me ligjin përzgjedhjet lokale. Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka 41 anëtarë.

Kryetari i Komunës zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga njerëzit që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet komunale në fuqi. Kryetari i Komunës zgjedhet përmendat (kater vjeqar) sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës në pajtim me ligjin. Zgjedjet e ardheshme lokale pritet te mbahen ne fund te vitit 2013 .

- **Lista e departamenteve të qytetit :**


Në bazë të nenit 62.1 të LVL, administrata komunale organizohet në drejtori ku përfshijnë:

1. Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme;
2. Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
3. Drejtorinë e Arsimit,
4. Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
5. Drejtorinë përm Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
6. Drejtorinë e Inspeksionit
7. Drejtorinë përm Shërbime Publike
8. Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë
9. Drejtorinë përm Rini, Kulturë dhe Sport,
10. Drejtorinë përm Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim dhe
11. Drejtorinë përm Mbrojtje dhe Shpëtim

Çdo drejtori komunal ka drejtorin që emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i komunës, në pajtim me nenin 62.2 të LVL. Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtorinë e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të komunës dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

Përpos drejtorive komunale, kuvendi i komunës se Gjilanit ka te themeluara edhe këto zyre: Zyrën e Kryetarit; Zyrën për Integrime Evropiane; Zyrën për Informim; Zyrën Ligjore; Zyra për personel, Zyrën e Avokatit të Komunës, Zyrën e prokurimit; Njësia e Auditimit të Brendshëm; Zyrën për Projekte; Zyra për Barazi Gjinore dhe Drejta të Njeriut, Qendra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkiva, Zyra për Komunitete

Organogrami :



- Informatat për departamentin e policisë – koha e reagimit & Informata rreth departamentit të zjarrfikësve

Kompetencat e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim janë: sistemimin e qytetarëve në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; vlerësimin e rrezikshmërisë për territorin e komunës; kompetencat e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në sferën e mbrojtjes nga zjarri janë: merr të gjitha masat e veçanta për mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri; i propozon Kuvendit të Komunës nxjerrjen e planit për mbrojtje nga zjarri, në mbështetje të vlerësimit të rrezikut nga zjarri në pajtim me udhëzimet e lëshuara nga ministria; kërkon ndihmë profesionale nga departamenti lidhur me shërbimin e zjarrfikësve .

Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim koordinon bashkëpunimin dhe organizimin e punës me organet e sigurisë në komunë, me KFOR-in, policinë dhe forcat e sigurisë; në sferën e parandalimit të zjarreve.


Sipas raporteve te Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Policise se Kosoves dhe KFOR-it Komuna e Gjilanit eshte njera nder komunat ku tolernaca nderetinike dhe siguria eshte ne nivle shume te larte .

## Kujdesi shëndetësor

- Numri i mjekëve në zonë dhe specializimi i tyre : Spitali Regional i Gjilanit ka 527 punore prej tyre 120 mjekë specialiste, 320 infermieri, ekonomiste, ingjinjer, jurist dhe puntore tjere ndimes .
- Spitali më i afërt : Spitali Regional i Gjilanit funksionon ne kuader te Ministrise se Shendetësise dhe ofron sherbime shendetësore per nivelin dytesor per popullaten e regionit te Gjilanit qe perfshin komunat : Gjilan, Kamenicë, Ranillugu, Novoberda, Parteshi, Kllokot, Viti si dhe Komunat Preshevë, Medvegjë, Bujanovcë (Serbi) dhe Kumanovë (Maqedoni)
  - Numri i shtretërve : Spitali Regional i Gjilanit ka kapacitet prej 450 shtreterve, 6 departamente dhe rrethe 25 m<sup>2</sup> siperfaqe te shfrytueshme
  - Fushat e kujdesit shëndetësor : Spitali Regional i Gjilanit ka 17 reparte : gjinekologjia, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektiva, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë -emergjencia, ORL, oftamologjia, laboratori, transfuzioni i gjakut, materniteti etj.
  - Kapaciteti i Shendetësise Primare dhe Qendrat tjera : Komuna e Gjilanit ka një shtëpi shëndeti, dhe 30 ambulanta, ku janë të punesuar 244 punore (mjekë dhe infermier) si dhe 51 ordinanca private, po ashtu kemi dy qendra dhe ate: Qendrën për Sherimin Mental dhe Qendrën për Rehabilitim Mental, njehërit kemi edhe Qendren per mbrojetjen e Gruase dhe Femijes si dhe Qendren e e Puneve Sociale e cila trajton rastet sociale



11/10/11



11/10/02

Foto : Hapsira e Spitalit Rajonal te Gjilanit

## Banimi

- Llojet e vendbanimeve
  - Shtëpia & Banesa :

| Banesat | Ekonomit familjare | Gjithësejt | Meshkuj | Femra |
|---------|--------------------|------------|---------|-------|
| 23186   | 17048              | 90015      | 45323   | 44692 |

<http://esk.rks-gov.net/rekos2011>

- Shpenzimet e zakonshme për banim

- Qiraja : Ne komunen e Gjilanit, qiraja mujore e banimit sillet nga 150 – 300 ne muaj varsishe nga madhesia e objektit te banimit dhe kushteve ne te, ndersa qiraja për shfrytëzim të pronës komunale është më sa vijon:
  1. Të gjitha objektet e ndërtuara me material ndërtimor të fortë e me destinim lokal afarist paguajnë qira mujore prej ..... 6 euro për  $1m^2$ ,
  2. Sipërfaqet e lokaleve afariste të përcaktuara si depo paguajnë 30% nga vlera e përcaktuar sipas nenit 10.2 pika 1)
  3. Bodrumet të cilat shfrytëzohen dhe janë të destinuara si lokale afariste paguajnë qira sipas nenit 10.2 pika 2)
  4. Objektet të cilat me destinacion janë përcaktuar si depo materiali paguajnë qira mujore 1 euro për  $m^2$
  5. Për objektet e përkohshme pronë komunale (të ndërtuara me material montues) të cilat kanë qasje direkt në rrugë kryesore qiraja mujore është 5 euro për  $1m^2$ , kurse të tjera 3 euro për  $m^2$
  6. Për objektet e përkohshme (kiosket, barakat) të vendosura në pronën komunale 3 euro për  $1m^2$
  7. Për vendosjen e garazheve montuese në pronën komunale për automjete të vogla 50 euro në vit.

Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale nëpër vendbanime dhe vise tjetra rurale të KK-së Gjilan është si vijon:

- a) Çmimi i qirasë mujore për zonën e parë që përfshin pronat komunale që shtrihen përgjatë rrugës magjistrale është 0.10 euro për  $1m^2$ ,
- b) Çmimi i qirasë mujore për zonën e dytë që përfshin pronat komunale në periferi të rrugëve magjistrale është 0.08 euro për  $1m^2$ ,
- c) Çmimi i qirasë mujore për zonën e tretë që përfshin pronat komunale kodrinore-malore është 0.05 euro për  $1m^2$  dhe
- d) Për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe deri në  $10 m^2$ , qiraja mujore do të jetë 20 euro, kurse për çdo  $m^2$  mbi  $10 m^2$  paguhet shtesë 1 euro për  $m^2$ .

Qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale me qëllim të vendosjes apo ndërtimit të objekteve për veprimtari të caktuar është si vijon:

- a) Çmimi i qirasë mujore për zonën e parë është 1.00 euro për  $1m^2$ ;
  - b) Çmimi i qirasë mujore për zonën e dytë është 0.75 euro për  $1m^2$ ;
  - c) Çmimi i qirasë mujore për zonën e tretë është 0.50 euro për  $1m^2$ .
- Komunalet : ZYRA RREGULATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA bene licencimin e ndermarrjeve per grumbullimin e mbeturianve dhe percakton tarifat e sherbimit per shërbimet e grumbullimit dhe deponimit te mbeturinave .
  - Parkingu : problem është edhe mungesa e parkingjeve në qytet, mirpo në qytetin e Gjilanit mund të gjenden 5-6 parkingje private me pagesë te cilat ne mase te madhe e zbusin mungesen e parkingjeve ne qytet. Komuna ne plan afate gjate ka parpare shtimin e numrit te parkingjeve .
  - A ka ndonjë agjenci që mund të ndihmojë të huajt të gjejnë banesë dhe të kuptojnë kontratat e qirasë? E kzistojne disa agjensi te cilat miren m shitjen e pronave, shtepive dhe gjetjen e banesave me qira ne baze te kerkesave .

## Cilësia e jetesës së komunitetit – Çfarë e bën komunën unike?

- Hotelet & Restorantet :

Në komunën e Gjilanit janë 244 ndërmarrje dhe punëtori hoteliere të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime të fjetjes, ushqimit, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, ahengjeve familjare, bankeve, seminareve, trajnimeve dhe shërbimeve të tjera. Hoteleria furnizimin me mallra e bën nga tregu i brendshëm, mall i cili kryesisht është importuar nga shtetet ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore. Objektet hoteliere kryesisht janë të ndërtuara në brendi të qytetit dhe pjesërisht në pjesët periferike.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 976 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 4,762,409 €/vit. Kapacitetet e objekteve hoteliere janë 14,640 m<sup>2</sup>. Fillet e zhvillimit të bizneseve hoteliere janë nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të hotelerisë është bërë në katër vitet e fundit.




Foto : motel "Kosova" & Restorandt "Vali Ranch"

- **Bankat** : Ekzistojnë 7 banka private komerciale: Pro-Credit Banka dhe Raiffeisen Banka janë në pronë të aksionarëve internacionale, kurse Banka e Biznesit Privat, TEB Banka, Banka Ekonomike dhe Banka Kombëtare Tregëtare janë në pronësi të kapitalit vendas, e gjithashtu edhe NLB e cila është në pronësi të kapitalit të përbashkët Kosovar-Sloven. po ashtu kemi edhe dy institucioneve mikro-financiare jo-profitabile që operojnë në Gjilan: FINCA dhe Programi i Ndërmarrjeve të Kosovës (KEP), të cilat kreditojnë mikro-firmat vetëm për kapital qarkullues .
- **Zonat për të bërë Pazar** : Tregu i qytetit në Gjilan funksionon qe nga vitet 1960, tregu i gjelbër paraqet hapësirën më të rëndësishme të qytetit, brenda hapesires se tregut sot ofrohen keto sherbiem per qytetare : Hapesira për qarkullimin e pemëve dhe perimeve, për qarkullimin e mallrave te tekstit, stofit, veshmbathjeve, bizhuterisë dhe produkteve te tjera, për qarkullim të produkteve dhe te gjysme produkteve te drurit si dhe mobilet, për qumëshit dhe produkte të qumështit, për prodhimet nga bletaria, për produkte te artizanaleve për drithëra dhe shërbime tjera te përziera.



- OJQ-të : shoqëria civile në këtë komunë është mjaft aktive, Organizata më e madhe jo qeveritare është Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC) dhe Klubi i Gazetareve " Beqir Musliu" , këto organizatë ka zbatuar shumë projekte që kanë të bëjnë me monitorimin e qeverisjes komunale apo ofrimin e alternativave për një qeverisje më të mirë. Organizatë tjetër aktive është edhe OJQ "Paqja me Natyrën" e cila është e orientuar shumë më shumë drejt problemeve që kanë të bëjnë me mjedisin dhe e cila ka shtyrë shumë projekte përpara në agjendën komunale. Shoqata e gruas "Liria" është organizatë e cila merret me çështjen e grave dhe përkujdesjes sociale. Kjo shoqatë merr një financim të konsiderueshëm nga ana e komunës për implementimin e projekteve sociale. ANP (Aksioni për Ndërtimin e Paqes) është organizatë tjetër aktive. Aktivitetet kryesore të ANP-së janë fuqizimi i rinisë dhe pajtimi ndëretnik. Në këto dy fusha ANP ka pasur disa aktivitete edhe në komunën e Kamenicës dhe Novobërdës. Ekzistojne mbi 100 shoqata te ndryshme nga te gjithe sektoret por nuk jane shume aktive .
- Mediat Lokale : Në komunën e Gjilanit funksionojnë tri televizione lokale (TV Vali, TV Men dhe TV Puls) dhe katër radio lokale (Radio Energy, Radio Victory, Radio Star dhe Radio MegaVox). Në përgjithësi, Gjilani ka media të pavarura dhe profesionale në punën e tyre. Po ashtu, Gjilanin e mbulojnë edhe gazetat më të mëdha ditore perms korrespondentëve të tyre të përhershëm në terren, ka edhe portalin e lajmeve lokale - web faqen <http://www.2lonline.com> e cila mbulon komunat e regjionit te Gjilanit me me te rejat .
- Organizatat e specializuara për të ndihmuar të huajt : Në Komunën e Gjilanit ekziston një zyre e Kryqit të Kuq, ata distribuojnë me të mirat të cilat i marrin nga OJQ-të dhe organizatat tjera; ata dhurojnë pako higjenike dhe gjera tjera sipas nevojes, po ashtu ekziston edhe zyra per riintegrin brenda komunes se gjilanit e cila ka ne perkujdese personat qe kthehen nga vednet e treta dhe ata zyra per kthim dhe komunitete e cilat ka ne perkujdese familjet e kthyera .
- Zonat për rekreacion :



- Parqet :




- Lokacionet rekreative në ambient të hapur – sportet :

Komuna e Gjilanit, si për nga vëllimi e sasia, ashtu edhe niveli artistik i veprimtarisë kulturore dhe sportive, por edhe numri i manifestimeve, dhe shkalla e lartë e organizueshmërisë – padyshim është njëra ndër më të dalluarat në Kosovë



- **Lokacionet/aktivitetet kulturore :**

Jeta kulturore në komunën e Gjilanit, si sferë kaq e rëndësishme e superstrukturës shoqërore, ka një traditë që daton menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, dhe u zhvillua me batica e zbatica - varësisht nga rrëthanat politike e shoqërore të një sistemi monist sllavokomunist, i cili në të shumtën e rasteve u përpooq të neglizhojë e pengojë zhvillimin e kësaj sfere në funksion të kultivimit dhe formësimit të një identiteti etnik shqiptar.



- **Lokacionet e kultit :**

Në komunën e Gjilanit janë 31 xhami, një kishë katolike si dhe një Teqe. Lufta i ka shkatërruar tërësisht 5 xhami, ndërsa 9 të tjera, pjesërisht. Kisha katolike në fshatin Dunavë (zonë kufitare me Preshevën dhe Kumanovën) nuk kryen më shërbesa, sepse nuk ka as popullatë që jeton atje. Komuna, në marrëveshje me Ipeshkvinë e Kishës katolike e ka marrë nën përkujdesje të veten këtë monument fetar. Në komunën e Gjilanit janë edhe 9 kisha ortodokse



- Ngjarjet e veçanta – pardat, festimet, festivalet, koncertet muzikore, ceremonitë :

Aktiviteti dhe veprimtaria e vrullshme në këto katër segmente të arteve që zhvillohen në komunën e Gjilanit, bëri që të lindin edhe një sërë Manifestimesh kulturore, të cilat i sublimojnë këto veprimtari, ndërkaq që, nëse pikërisht aktiviteti i lindi ato, ato në fakt e nxisin veprimitarinë edhe më të bujshme, kështuqë në këtë drejtim kemi **të bëjmë** më një korelacion të dyanshëm e të ndërsjellë.

- ***Flaka e Janarit*** – është Manifestim që i sublimon në mënyrën më të mirë që të gjitha këto veprimtari, sepse në fakt përbëhet nga arti letrar, arti skenik, ai muzikor dhe ai pamor, në nderim të pietetit të martirëve të kombit që nga Epoka e lavdishme e Skënderbeut e deri tek periudha pokaq e lavdishme të Ushtrive tona Kombëtare Çlirimtare, që mbahet ne kapërcyllin kohor 11-31 janar, në të cilin marrin pjesë rreth 500 krijues para rreth 4.524 dashamirësve dhe njohësve të këtyre arteve.

- ***Çmimi Letrar "Beqir Musliu"***. – Në shenjë të nderimit të figurës letrare të njërit ndër shkrimtarët më të mëdhenjë shqiptarë, gjilanasit Beqir Musliut (1945-1996), në ditëlindjen e tij (më 11 qershor), organizohet Akademi Letrare me ç'rast, i ndahet solemnisht çmimi letrar për vepër letrare krijuesit më të dalluar shqiptar gjatë vitit gjegjës, sipas vlerësimit të Jurisë gjegjëse, Çmim ky i cili e mbanë emrin e këtij letrari, me çka, nderohet emri dhe vepra e këtij kolosi të letrave tona, sikundër që nderohen edhe krijuesit aktualë më të dalluar kombëtarë.

- ***Festivali Kombëtar i Folklorit***. - Me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të “konservimit” të folklorit burimor anamoravas dhe me synim që të nxitet kjo veprimitari e trashëgimisë kulturo-historike, organizohet ky Manifestim mbarëkombëtar në të cilin marrin pjesë rreth 13 shoqeri të të gjitha trojeve tona etnike me rreth 1,500 anëtarë, të cilët, për tri ditë, shpalosin repertorin e tyre të begatshëm para rreth 2,300 spektatorëve.

- ***Takimi me më të dalluarit***. - Me qëllim të nxitjes së vlerave më të larta kulturore, sportive dhe të sferës së rinisë, në prak të përmbylljes së vitit gjegjës kalendarik, organizohet Manifestimi “Takimi me më të dalluarit”, në të cilin, më të dalluarit në të gjitha segmentet kulturo-artistike, sportive e rinore, nderohen me Çmime, dhurrata e mirënjobe, në një solemnitet kulturo-artistik.

***Panairi vjetor i librit***. - Tradicionalisht, nisur 21 vite më parë, Biblioteka Ndërkunale “F. Noli”, organizon Manifestimin “Panairi i Librit”, me karakter shitës, deri më 20 për qind të çmimit të zbritur, ku marrin pjesë mbi 40 editorë të arealit mbarëkombëtarë shqiptarë, me mbi 12,000 titujsh, që me të madhe shërben si një hallkë e fortë midis autorëve, botuesve dhe lexuesve, dhe po ka ndikim të madh në popullarizimin e librit.



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - Gjilan  
Fadil OSMANI, Zyrtar për Promovimin e Investimeve  
mob: +377 45 218 100  
E-mail: fadilosmani02@yahoo.com